



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS						
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Gjuhë dhe letërsi shqipe	Viti akademik	2020-21	
LËNDA	Letërsi moderne II					
Viti	i tretë	Statusi i lëndës	Obligative	Kodi		ECTS kredi
Semestri	i pestë					6
Javët mësimore	15 (pesëmbëdhjetë)		Orët mësimore 3+2		Ligjërata	
Metodologjia e mësimit dhe përshkrimi i lëndës	Ky kurs u mundëson studentëve njohjen me letërsinë moderne shqipe, pra deceniet e para të shekullit XX, duke përfshirë këtu njohjen e rrymave, individualizmin krijues në letërsinë shqipe, shfaqjen dhe konsolidimin e të gjitha formave letrare, kahjet e mendimit teorik-kritik për problemet e letërsisë, si dhe kulturën nacionale në përgjithësi. Përveç kësaj, studentët do të pajisen me dije dhe shkathtësi, e cila do t'ua mundësojë hulumtimin, analizimin e studimin e pavarur të teksteve letrare.					
Mësimdhënës	Prof.asoc.dr. Teuta Vinca- Kafexholli		e-mail	teuta.kafexholli@uni-prizren.com		
			Tel.	045- 405 444		

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Qëllimi i kursit Letërsia moderne është:</p> <ul style="list-style-type: none"> njohja e letërsisë moderne shqipe dhe aftësimi për njohjen e konteksteve që kanë ekzistuar në kulturën shqipe në deceniet e para të shekullit XX; përvetësimi i diturisë së përgjithshme ndaj krijimeve letrare në letërsinë shqipe që nga fillimi i shekullit XX me veprat më të njohura letrare dhe përfaqësuesit më të denjë të tyre; aftësimi për debatimin e vlerave letrare; 	<p>Studentët do të jenë në gjendje të fitojnë njohuri:</p> <ul style="list-style-type: none"> për autorët dhe format e periudhës përkatëse; për konceptet substanciale të zhvillimit të letërsisë, kryesisht në letërsinë shqipe; që të dallojnë dhe njohin format e strukturat letrare – prozë, poezi, dramë – në kuadër të shfaqjes dhe konsolidimit të tyre, si dhe rrymat e mendimit teorik e kritik për letërsinë dhe kulturën shqipe në përgjithësi; që të hartojnë dhe zhvillojnë analiza, interpretime, studime të pavarura për letërsinë, tekstet dhe autorët e veçantë në kuadër të lëndës, por edhe jashtë saj; që ta plotësojnë korpusin e njohjes dhe studimit të letërsisë nacionale dhe ta

shtojnë kreativitetin hulumtues në fushën e shkencave humane në përgjithësi.

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:

Ligjëratat do të organizohen në modelin ndërveprues apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit.

Kushtet për realizimin e temës mësimore:

Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjëratat në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit) etj.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)

Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.

Pikët e vlerësimit:

Testi i parë: 15 pikë
 Testi i dytë: 15 pikë
 Punim seminari 10 pikë
 Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë
 Vlerësimi i fundit testi përfundimtar 50 pikë.
 Totali: 100 pikë

Vlerësimi në %

Nota përfundimtare

Vlerat e pikëve:

51-60 = 6
 61-70 = 7
 71-80 = 8
 81-90 = 9
 91-100 = 10

Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.

Obligimet e studentit: Të jetë pjesëmarrës aktiv, të punojë seminarat; prezantimet dhe hulumtimet e pavarura. Gjatë ligjëratave nuk i lejohet komunikimi me telefon apo modele të tjera të cilat pengojnë procesin e mësimin. Gjatë organizimit të testeve nuk lejohet kopjimi, komunikimi apo ardhja me vonesë, sepse do të pengojë procesin e organizimit të testit.

Testi apo provimi organizohet sipas plan-programit të paraparë dhe zgjatë një orë mësimore.

Ligjëratat

Në ligjëratat studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.

Ushtrime

/

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	3	15	15
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	15	15
Seminare, teste, kolokfiume etj.	4	2	8

Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	4	2	8
Projekte, prezantimet etj.	3	1	3

Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë	Ngarkesa totale:	150

Java	Ligjërata	
	Tema	Orët
1.	Hyrje në lëndë- Tiparet e letërsisë shqipe të epokës moderne <ul style="list-style-type: none"> • Periudha mes dy luftimeve botërore, lëvizje për shndërrime demokratike në jetën e shoqërisë shqiptar • Patosi realist e kritik • Përvoja artistike botërore dhe laramania e stileve të përfaqësuesit modern në letërsinë tonë 	3
2.	Modernizmi dhe letërsia shqipe <ul style="list-style-type: none"> • Modernizmi dhe vlera • Kategoritë përshkruese të modernizmit • Format letrare • Vetëdija për letërsinë • Qarku kulturor e historik 	3
3.	Modernizmi dhe avangarda <ul style="list-style-type: none"> • Ngjashmëritë dhe dallimet • Modernizmi dhe vlerat • Kategoritë përshkruese • Modernizmi i keqkuptuar 	3
4.	Lasgush Poradeci <ul style="list-style-type: none"> • Lajmëtar i bashkëkohësisë • Lirikat e tij • Figura kosmike në poezi • Poeti dhe liria • Poezitë e dashurisë • Vdekja e përjetësia • Testamenti poetik • Analizë e poemës “Eskursioni teologjik i Sokratit” • “Vallja e Yjeve” • “Ylli i Zemrës” • “Kamadeva” 	3
5	Etëhem Haxhiademi <ul style="list-style-type: none"> • Tragjediani më i njohur i viteve `20 dhe `30 	3

	<ul style="list-style-type: none"> • Subjektet nga letërsia antike greke, nga rrënjët e historisë shqiptare • Subjektet nga historia kombëtare, nga trashëgimia biblike • Analizë e tragjedisë “Skënderbeu” • Analizë e tragjedisë “Abeli” me shtrirje moralizuese 		
6.	Ernest Koliqi <ul style="list-style-type: none"> • Poezia • Tregimet • Novelat moderne • “Hija e Maleve” • “Tregtar flamujsh” • ” Pasqyrat e Narçizit” • “Gjurmata e stinve” 	3	
7.	Provimi i parë intermediar	3	
8.	Mitrush Kuteli <ul style="list-style-type: none"> • Jeta dhe vuajtjet e Kutelit në rrugën e tij jetësore: ecje vertikale kuteliane në tri regjimet e Shqipërisë • veprimtaria e gjithëmbarshme • Poezia • Tri tekstet autobiografike • Për parathënien “Një fjalë mbi dy shokë e mbi veprën e tyre” • Analizë e përmbledhjes poetike “Sulm e lot” • Poezitë për jetën apo fund-jetën • Veprat me kritikë dhe përkthimet 	3	
9.	Mitrush Kuteli <ul style="list-style-type: none"> • Proza • Nismëtar i modernitetit në prozën shqipe • Tregimet e rrëfenjat • Tema e hakmarrjes, misteri i dashurisë • “Vjeshta e Xheladin Beut”, novelë kryevepër e prozës moderne • “E madhe është gjëma e Mëkatit” (Tat Tanushi). Mëkatet e Tatës • “Net shqiptare” • ” Ago Jakupi e të tjera rrëfime” 	3	
10.	Migjeni <ul style="list-style-type: none"> • Migjeni, lajmëtarët e bashkëkohësisë • Miti për poetin e ri • Zë i veçantë i brezit letrar i viteve tridhjetë • Toni meditativ në poezitë e tij • “Vargjet e lira” dhe struktura e librit: • Parathënie e parathënies (si hyrje) • Këngët e ringjalljes • Këngët e mjerimit • Këngët e përndimit • Këngët në vete • Këngët e rinisë 	3	

	<ul style="list-style-type: none"> • Këngët e fundit 		
11.	Migjeni <ul style="list-style-type: none"> • Migjeni dhe risitë letrare në prozë • Skicat letrare • Novelëzat • “Novelat e qytetit të veriut”, vepër letrare në prozë • Kodi moral i personazhit • Fati i femrës në prozat e Migjenit • Rrathët tragjik, ankthi dhe vuajtja shpirtërore në prozat e tij 	3	
12.	Nonda Bulka <ul style="list-style-type: none"> • Prijëtari i letërsisë sociale • Vlerat letrare të prozës së paraluftës • Kritik i rreptë i shoqërisë së kohës; prijëtar i letërsisë së angazhuar • Nonda Bulka një prej korifenjve të letërsisë shqipe • “Kur qan e qesh bilbili” • Toni ironik në tregime dhe skica • Kritika letrare mbi veprën e N. Bulkos 	3	
13.	Haki Stërmilli <ul style="list-style-type: none"> • Jeta dhe krijimtaria letrare • Nga fusha e letërsisë dokumentare e autobiografike • Trilogjia dramatike “Dibranja e mjerueme”, “Dashuni e besniku”, “Agimi i lumnueshëm” • “Sikur t’isha djalë”, roman në trajtën e ditarit • Tema sociale dhe mbështetja në ndjeshmëri sociale • “Kalorësi i Skënderbeut” Sterjo Spasse <ul style="list-style-type: none"> • Romani i ideve “Nga jeta në jetë- Pse?!” • Romani “Pse”, roman social me një shtresim të fuqishëm filozofik • Gjona Zavri, krijimi i personazhit medtativ • Romani “Aërdita” dhe personazhja misionare në jetën shoqërore të realitetit shqiptar 	3	
14.	Eqrem Çabej për letërsinë shqipe Arshi Pipa, Esad Mekuli, Mustafa Greblleshi, Qamil Draçini, Thoma Kacori Analizë e veprave letrare	3	
15.	Provimi i dytë intermediar	3	

LITERATURA BAZË

Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Shtëpia Botuese Universitare "UET Press", Tiranë, prill, 2013.
Grup autorësh: *Historia e letërsisë shqiptare*, "Rilindja", Prishtinë, 1989.
Robert Elsie: *Historia e letërsisë shqiptare*, "Dukagjini", Pejë, 2011.

LITERATURA SHITESË

Eqrem Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në "Studime gjuhësore", vëllimi V, "Rilindja", Prishtinë, 1988.
Grup autorësh: Gjergj Fishta
Sali Bashota, *Proza e filleve të modernitetit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006.
Mendimtarë shqiptarë, *Plagët tona*, Dija, Prishtinë, 2000.
Teuta Vinca-Kafexholli, *Kronotopi në prozën "E madhe është gjëma e mëkatit"*, Meshari, Prishtinë, 2014.
Teuta Vinca- Kafexholli, *Mitrush Kuteli si folklorist dhe poet*, Iris, Strugë, 2008.
Hysen Matoshi, *Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore*, Instituti albanologjik, Prishtinë, 2008.
Jorgo Bullo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë, 1998.

Vërejtje:

Ky plan-program (Syllabus) mund të ndryshojë dhe të plotësohet pjesërisht gjatë vitit akademik. Për çdo ndryshim, studentët do të informohen.

Vërejtje për studentin:

Studentët janë të obliguar që t'i vijojnë me rregull ligjëratat. Gjatë procesit të mësimit kërkohet të respektohen rregullat e mirësjelljes: ardhja në kohën e caktuar, qetësia në mësim. Gjithashtu ndalohet përdorimi i telefonave celularë